



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.31.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË HANIT TË
ELEZIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës së Hanit të Elezit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu , i mbështetur nga, Luljeta Morina (Udhëheqës Ekipi), Kreshnike Haziri dhe Qendresa Sogojeva.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak	11
4 Qeverisja	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	21
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	23


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të komunës së Hani të Elezit për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.


(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar)

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti ka të dizajnuar një sistem të kontrollit të brendshëm në të gjitha sistemet kyçe të komunës. Megjithë progresin e arritur, disa nga kontrollet nuk ishin efektive gjatë tërë vitit 2014.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e komunës janë:





Përgjigja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i komunës është pajtuar me të gjitha gjetjet tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në këtë raport.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari:

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/Shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e komunës së Hanit të Elezit të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Cilësia e PVF në përgjithësi ishte e mirë, ku u identifikuan vetëm një numër i vogël gabimesh jo materiale dhe të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar)

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit të datës 07.11.2014, është identifikuar një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Ky është një rrezik i anomalive materiale të cilat mund të rezultojnë me modifikim të opinionit.

Rreziku i anomalive që ne kemi identifikuar në fazën e planifikimit në lidhje me plotësinë e pasurive nuk ka ndodhur. Kjo, për shkak të veprimit specifik që ka marrë Kryetari i komunës për ta zbatuar këshillën tonë për adresimin e rrezikut. Komuna ka ndërmarrë veprime gjithëpërfshirëse për të siguruar që të gjitha pasuritë mbi 1,000€ janë regjistruar dhe prezantuar në mënyrë të drejtë në PVF. Kur është fjala për prezantimin e asetëve nën 1,000€, ende ekzistojnë disa gabime jo materiale.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna e Hanit të Elezit duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës);
- Nëse draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar më kohë;

Lidhur me PVF ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memon tonë të Auditimit të ndërmjetëm, të datës 19/12/2014, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti, me përjashtim të disa shpalosjeve jo-materiale në shënimin 31 dhe 32.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm për vitin 2014, dëshirojmë të theksojmë që komuna nuk kishte përgatitur raportin e performancës për vitin 2013 dhe një mospajtueshmëri e tillë mund të përsëritet edhe për vitin 2014.

Rekomandimi 1 Prioritet i Mesëm - Kryetari duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve për 2015 të përfshijë prezentim të plotë dhe të saktë të pasurive nën 1,000€ dhe të stoqeve në fund të periudhës. Raporti i performancës, si kërkesë statutoe e komunës, duhet të publikohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka përgatitur një Plan të Veprimit dhe ka bërë përpjekje për adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak, megjithëkëtë ato ende nuk janë adresuar plotësisht.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar në 8 rekomandime kryesore.

Deri në fund të auditimit për vitin 2014, dy (2) rekomandime ishin adresuar plotësisht, katër (4) pjesërisht, dhe dy (2) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II

Rekomandimi

Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i Lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Pjesa më e madhe e rekomandimeve janë trajtuar nga menaxhmenti, ndonëse gjysma e rekomandimeve vetëm pjesërisht ishin adresuar. Komuna nuk ka zbatuar një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar që zbatimi i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm zhvillohet në përputhje me Planin e Veprimit. |
| Rreziku | Mos implementimi i të gjitha rekomandimeve ka rezultuar me përsëritjen e disa dobësive të identifikuara në vitet e kaluara. Kjo mund të shkaktojë humbje potenciale financiare dhe vlerë të ulët për paranë e paguar. |
| Rekomandimi 2 | Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit për vitin 2014 do të përcaktoj një afat të arsyeshëm kohor brenda të cilit do të caktohen edhe personat përgjegjës dhe aktivitetet praktike për adresimin e rekomandimeve të AP, me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet direkt nga Kryetari. |

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Një qeverisje e mirëfilltë ka për qëllim mbështetjen për planifikimin efektiv, implementim dhe monitorim të aktiviteteve financiare dhe operacionale të komunës.

Disa nga aspektet kyçe që duhet adresuar për të mundësuar një kornizë të tillë qeverise janë:

- Menaxhimi i rrezikut - ku komuna ende nuk ka vendosur procedura formale dhe të dokumentuara për menaxhimin e rrezikut;
- Sistem të auditimit të brendshëm - ku komuna nuk ka themeluar Njësinë e Auditimit dhe Komitetin e Auditimit; dhe
- Monitorimi sistematik dhe efektiv të aktiviteteve - ku komuna ka filluar nga viti 2015 të formalizojë raportimin te niveli i lartë i menaxhmentit dhe ta dokumentojë atë.

Megjithë progresin e arritur, aranzhimet e qeverisjes së përgjithshme duhet të forcohen për të siguruar menaxhim efektiv të komunës, vlerë më të mirë për para, dhe përmirësim të mëtutjeshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrimi

Procedurat e një qeverisje të mirë kanë për qëllim të konfirmojnë që menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë dhe vendimmarrja është efektive dhe mbi baza të duhura. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur të menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve të identifikuara operative dhe financiare.

Ne vlerësojmë disa aktivitete që komuna ka ndërmarrur me qëllim të sigurimit të një mjedisi më të mirë të kontrollit, përfshirë vetëvlerësimin - ku komuna ka zbatuar kërkesën e MFK-së për kryerjen e vetëvlerësimit. Si rezultat i veprimeve të përgjithshme qeverisëse, komuna ka përmirësuar menaxhimin e automjeteve, forcimin e kontrolleve në mbledhjen e të hyrave dhe barazimet mujore të tyre, dhe dokumentimin e takimeve përmes procesverbaleve.

Rekomandimi

Çështja 3 – Aranzhimet e qeverisjes së përgjithshme - Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna nuk posedon një plan strategjik që do të përcaktonte objektiva të qarta zhvillimore. Mungesa e planit strategjik vështirëson hartimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore të komunës në afat të gjatë, si dhe vendimmarrjen për projekte shumëvjeçare;

Në mungesë të një dokumenti strategjik për zhvillim afatmesëm të komunës, dhe për shkak të dallimeve politike ndërmjet Kryetarit dhe Asamblesë Komunale, miratimi i buxhetit për vitin 2014 nuk ishte bërë me kohë. Kjo ka rezultuar me buxhet të njëjtë si në vitin paraprak, duke kufizuar menaxhmentin që të realizojë objektivat e planifikuara, në veçanti përfshirjen e projekteve të reja; dhe

Komuna nuk ka themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe Komitetin e Auditimit (KA). Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kuptimit të rëndësisë së këtyre në përmirësimin e qeverisjes së përgjithshme.

Rreziku Mungesa e planit strategjik redukton efektivitetin e menaxhimit financiar dhe operativ të komunës dhe mund të rezultojë me ngecje potenciale në realizimin e objektivave të përgjithshme të komunës. Vonesa në miratimin e buxhetit ka pasur efekt negativ në realizimin e projekteve të planifikuara. Mungesa e NjAB-së dhe KA-së ka rezultuar me mungesë vlerësimi dhe sigurie mbi operimin dhe efektivitetin e kontroleve të brendshme.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet t'i rishikojë aranzhimet aktuale të qeverisjes. Meqenëse është një dokument mjaft kompleks, ne do të sugjeronim që komuna t'i çaset hartimit të një strategjie për zhvillim, dhe të njëjten ta miratoj brenda një afati të arsyeshëm, orientimisht brenda vitit 2015. Procedurat e miratimit të buxhetit vjetor duhet të fillojnë me kohë dhe t'i referohen Kornizës Afatmesme Buxhetore të komunave. Gjithashtu, si pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm, komuna duhet të themelojë Sistemin e Auditimit të Brendshëm (Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe KA).

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,832,040	2,046,665	1,902,070	1,877,073	1,920,082
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,482,040	1,647,998	1,620,495	1,525,696	1,536,638
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	27,183	27,144	60,262	81,072
Të hyrat vetjake ³	350,000	350,000	233,030	229,881	169,309
Donacionet e jashtme	0	21,484	21,401	61,235	133,063

Buxheti final është më i lartë sesa buxheti fillestar për 214,625€ si rezultat i:

- Rritjes së grantit qeveritar në shumë 165,958€;
- Bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak në shumë 27,183€; dhe
- Donacioneve të jashtme në shumë 21,484€.

Në vitin 2014 komuna ka përdorur 93% të buxhet final, një performancë të ngjashme me vitin 2013. Përveç për investime kapitale, komuna ka shfrytëzuar maksimalisht fondet në dispozicion në kategoritë tjera ekonomike. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,832,040	2,046,665	1,902,070	1,877,073	1,920,082
Pagat dhe Mëditjet	1,079,088	1,245,046	1,239,194	1,067,784	1,043,119
Mallrat dhe Shërbimet	174,168	174,296	147,697	202,151	257,182
Shërbimet komunale	37,500	37,500	35,918	33,551	38,764
Subvencionet dhe Transferet	32,000	37,245	37,163	27,477	41,465
Investimet Kapitale	509,284	552,578	442,098	546,111	539,553

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit nga bartja e të hyrave të vitit paraprak dhe donacioneve për shpenzime kapitale, vetëm 80% e buxhetit ishte shpenzuar. Ky suficit për këtë kategori ishte si

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

pasojë e planifikimit dhe menaxhimit joadekuat të projekteve, por edhe për shkak të mungesës së rishikimit buxhetor pasi që disa projekte kishin nevojë të rishikohen;

- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje prej 165,958€ është rezultat i rritjes së pagave prej 25% nga muaji prill, mbuluar nga Qeveria e Kosovës;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte shpenzuar në nivel 85% apo 10% më pak se në vitin paraprak. Ky zvogëlim ka ndodhur për shkak të vendimit qeveritar për shkurtrimin e shpenzimeve për 15% për këtë kategori; dhe
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte shpenzuar pothuajse 100% sepse komuna kishte arritur të bëjë menaxhim të mirë të shpenzimeve për këtë kategori.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetjake 2014	350,000	350,000	277,233	248,848	231,380

Në vitin 2014 komuna kishte realizuar planin për inkasimin e të hyrave vetjake në nivel 79%. Prej shumës së gjithmbarshme të të hyrave vetjake, 259,662€ kryesisht ishin mbledhur nga tatimin në pronë, licencat për aktivitete të ndryshme, taksat për ndrrim të destinimit të tokës dhe regjistrimi i automjeteve. Nga gjobat e policisë dhe gjykatat ishin mbledhur 17,571€.

Nga 304,416€ (të mbledhura në vitin 2014 dhe të bartura nga viti 2013) prej të hyrave vetjake që ishin në dispozicion gjatë vitit 2014, ishin shpenzuar 260,174€ apo 85%. Pjesa e mbetur prej 44,242 janë bartur për t'u shpenzuar në vitin 2015.

Rekomandimi

Çështja 4 - Shpenzimi i ulët për investime kapitale - Prioriteti i Lartë

E gjetura Buxheti për investime kapitale është shpenzuar në masë të njëjtë me nivelin e mbledhjes së të hyrave vetjake (rreth 80%) dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve (53%) ishte bërë në fund të vitit. Kjo ka ndodhur për shkak se plani i të hyrave vetjake nuk ishte realizuar sipas pritjeve fillestare si dhe pjesërisht për shkak të mosefikasitetit në realizimin e projekteve.

Rreziku Planifikimi jo real i të hyrave vetjake, ka rezultuar me mos realizimin e politikave në planin e investimeve publike. Shfaqja e suficitit për investime kapitale prej 100,000€ mund të jetë rezultat i një plani jo mirë të harmonizuar në mes rrjedhës së parasë dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit. Çështjet e përmendura mund të ndikojnë në dështimin e arritjes së objektivave të komunës në infrastrukturën komunale.

Rekomandimi 4 Para se buxheti të miratohet, Kryetari i komunës duhet të sigurohet se si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet e buxhetit, janë analizuar mirë, dhe se plani i rrjedhës së parasë është i harmonizuar me dinamikën e planifikuar të shpenzimeve. Përveç kësaj, përmirësime nevojiten edhe tek procesi i prokurimit dhe tenderimi i projekteve kapitale të bëhet me kohë.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Komuna ka vendosur një sërë kontrollesh në lidhje me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë prezantimin e tyre në PVF. Një sërë praktikash që kanë ndikuar në rritjen e inkasimit ishin zbatuar si: kushtëzimi për fshirjen e borxheve për tatimit në pronë; për pjesëmarrje në konkurse; për rekrutim; shlyerja e obligimeve ndaj komunës për ofertuesit në tendere; dhe publikimi i listës së zyrtarëve komunal që kanë obligime për tatim në pronë. Megjithë progresin e bërë, disa nga kontrollet nuk kanë qenë efektive në nivelin e pritur.

Rekomandimi

Çështja 5 - Dobësi në planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave- Prioritet i Lartë

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi në planifikimin e të hyrave vetjake sepse komuna nuk ka zbatuar politika konsistente lidhur me të hyrat. Me rastin e hartimit të planit për të hyrat vetjake, komuna nuk kishte merr parasysh trendin e inkasimit në tri vitet e fundit, dhe në vitin 2014 kishte planifikuar 40% të hyra më shumë sesa shuma e mbledhur një vit më parë. Nuk është e qartë cila ishte baza e pikënisjes për këtë planifikim. Si pasojë e kësaj, plani ishte realizuar 79%, por shuma e mbledhur ishte 11% më e lartë se në vitin 2013.

Planifikimi për tatim në pronë ishte 91,350€, përafërsisht aq sa edhe ishin inkasuar, përderisa faturimi ishte 97,203€. Poashtu, në 2 raste komuna kishte lëshuar vërtetime ndaj bizneseve që nuk i kishin paguar obligimet për tatim në pronë (10,810€). Kjo kishte ndodhur me aprovimin e menaxhmenti për shkak të vështirësive financiare të tatimpaguesve.

Rreziku Planifikimi jo real i të hyrave vetjake ndikon edhe në planifikimin e gabuar të projekteve potenciale për t'u financuar nga burimet vetjake, si dhe në shfaqjen e suficiteve fiktive të buxhetit.

Rekomandimi 5 Me rastin e hartimit të Planit vjetor të të hyrave, Kryetari duhet të sigurojë se trendi i të hyrave gjatë viteve të fundit është marrur parasysh dhe që zhvillimet e përgjithshme të komunës (zhvillimin ekonomik, ndërtime të reja, mundësinë e inkasimit të borxheve të mëparshme) dhe faktorët tjerë që mund të ndikojnë në zgjerimin e bazës për rritjen e të hyrave janë marrur në konsideratë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Shpenzimet përmes procesit të prokurimit përfshijnë pagesat për investime kapitale dhe një pjesë të pagesave për mallra dhe shërbime. Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike shpenzohet duke arritur vlerën për parën e paguar përmes një procesi transparent dhe efikas. Çështjet e ngritur nga auditimi në këtë fushë janë paraqitur në vazhdim.

Rekomandimi

Çështja 6 – Dobësi në prokurim – Prioritet i Lartë

E gjetura Shqyrtimi i kontratave dhe pagesave për shpenzimet përmes prokurimit ka vënë në pah disa dobësi për shkak të kontrolleve jo efektive dhe moszbatimit të kërkesave rregullative. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme:

Te projekti “Ndërtimi i aneksit të shkollës “Ilaz Thaqi”, komuna kishte nënshkruar kontratën dy vjeçare në vlerë prej 240,950€, perderisa për dy vitet ishin të planifikuara vetëm 137,000€. Kontrata “Shtrimi me kubëza nëpër lagje dhe fshatra” e ndarë në tri lote. Njoftimi për kontratë (për tri lotet) ishte bërë në vlerë totale 39,426€ ndërsa vetëm 20,000 ishin planifikuar. Për më tepër, kontrata ishte nënshkruar vetëm për lotin e parë në vlerë 22,767€ për shkak të mungesës së mjeteve dhe mungesës së parallogarive për dy lotet tjera.

Rreziku Dobësitë e identifikuar në shpenzimet përmes prokurimit kanë rezultuar me ngecje në realizimin e projekteve. Mungesa e mjeteve për projektet e filluara mund të rezultojë me vonesa në realizimin e projekteve dhe rritje të detyrimeve të komunës.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të përcaktojë pse kërkesat para fillimit të projekteve nuk janë përmbushur, si dhe të zotoj fondet e mjaftueshme para fillimit të secilit projekt kapital.

4.4.2 Shpenzimet pa procedura të prokurimit

Përshkrimi

Shpenzimet pa procedura të prokurimit janë shpenzimet për komunal, dreka dhe udhëtime zyrtare, etj.

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga Komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individë), si bursa për studentë dhe nxënës, subvencione për bujqësi dhe sport, subvencionim në emër të gjendjes së rëndë ekonomike, ndihma në ushqim dhe nevoja shëndetësore, përkrahje për familjet e dëshmorëve të luftës, etj.

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Komuna ka prezentuar pasuritë në vlerë prej 1,119,067€ në PVF-të e vitit 2014.

Ne kemi identifikuar një rrezik domethënës lidhur me plotësinë e pasurive të komunës. Kjo çështje është trajtuar në pjesën 2.2 – Rreziqet domethënëse.

Nuk kemi ndonjë rekomandim në këtë fushë.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Llogaritë e arkëtueshme janë borxhet e debitorëve të komunës që pritet të inkasohen në të ardhmen. Shuma e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2014 ishte 510,000€ apo 54% më larta se në vitin paraprak (330,000). Shumat kryesore të llogarive të arkëtueshme janë nga tatimi në pronë (268,000€), licencat për ushtrimin e veprimtarisë biznesore (220,000€) dhe shfrytëzimi i pronës publike (22,000€).

Rekomandimi

Çështja 7 -Vlera e lartë e të arkëtueshmeve – Prioritet i Lartë

E gjetura Vlera e llogarive të arkëtueshme është rritur sepse komuna nuk ka arritur të zbatojë mekanizma efektive për mbledhjen e të arkëtueshmeve. Edhe gjendja e rëndë ekonomike e qytetarëve ishte faktor për këtë nivel të të arkëtueshmeve.

Rreziku Niveli i lartë i llogarive të arkëtueshme zvogëlon mundësitë e komunës që të realizojë projektet e planifikuara. Mungesa e një strategjie të qëndrueshme për mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe vjetërsimi i borxheve zvogëlon gjasat për arkëtimin e tyre në të ardhmen.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës i qasjes së aplikuar për të arkëtueshmet dhe t'i identifikojë barrierat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes. Borxhet e vlerësuar si të vjetra dhe të paarkëtueshme duhet të fshihen (duke dokumentuar arsyet), ndërsa për pjesën tjetër duhet të zbatohet një qasje e hershme dhe efektive, përfshirë veprimet ligjore.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Borxhet e komunës paraqesin obligimet ndaj furnitorëve që do të paguhen në të ardhmen. Shuma e këtyre llogarive në fund të vitit 2014 ishte 47,193€ e që paraqet rritje të dukshme krahasuar me vitin 2013 (3,520€). Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Pjesa më e madhe përfshinë kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 44,163€.

Komuna u kishte dhënë prioritet pagesave të borgjeve gjatë periudhës së parë të vitit (deri më 05.03.2015) ishin paguar 52% të këtyre obligimeve.

Komuna kishte bërë raportimet mujore në Ministrinë e Financave gjatë tërë vitit 2014, siç e kërkohet me Rregulloren 04/2011.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Komuna ende nuk ka themeluar NJAB dhe KA. Themelimi i NJAB dhe KA është i rëndësishëm për t'i mundësuar menaxhmentit të marrë siguri për funksionimin e kontroleve të brendshme.

Rekomandimi

Çështja 8 – Mungesa e NJAB dhe KA - Prioritet i Lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Komuna e Hanit të Elezit ende nuk ka themeluar NjAB dhe KA. Kjo reflekton mungesën e kuptimit të rolit dhe rëndësisë që kanë këto dy organe për t'i ofruar menaxhmentit siguri për mjedisin e kontrollit të brendshëm. |
| Rreziku | Mungesa e funksionit auditimit të brendshëm mund të rezultojë me mos identifikim dhe adresim të dobësive të kontrollit që do të kishte si pasojë mos-efikasitet operacional dhe humbje financiare për komunën. |
| Rekomandimi 8 | Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet për themelimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm. |

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse:** (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose

së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare¹⁵⁸. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna 2013	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF.	<p>Ne këshillojmë që Kryetari i komunës të sigurohet se përgatitja e pasqyrave financiare do të përfshijë procedura dhe mjete të projektuara për t'u siguruar që informatat e kërkuara janë të regjistruara, të procesuara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të përshtatshme në pasqyra financiare.</p> <p>Informacioni mbi pagesat nga palët e treta, shumat e të arkëtueshmeve dhe detyrimeve kontigjente duhet të përditësohet rregullisht dhe të rishikohet për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e shpalosjeve të tilla në pasqyrat financiare.</p> <p>Komuna duhet të përgatisë pasqyrat financiare në gjuhën serbe.</p>	Po është adresuar.		
2. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak.	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, duke identifikuar stafin përgjegjës dhe duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesërisht e adresuar.	
3. Ekzekutimi i buxhetit.	<p>Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.</p> <p>Kryetari duhet të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetanake përbën plan realist dhe përkon me mundësitë e komunës për mbledhjen e të hyrave. Për më shumë duhet siguruar se janë ndërmarrë gjithë masat për mbledhjen e këtyre të hyrave.</p>		Pjesërisht është adresuar .	

<p>4. Kontrolli mbi të hyrat .</p>	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efçiente dhe efektive në faturim dhe të hyra të mbledhura. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurohet që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i këshillojmë Kryetarit të komunës të konsiderojë pikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementimin e një sistemi faturimi që përfshin detaje të përditësuara për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pagues. Qasja në informacione të tilla duhet të jetë e limituar vetëm për një numër personash dhe me autorizimin e menaxhimit. • Të vendosë dhe të kontrollojë në mënyrë qendrore tarifat dhe normat e taksave të aprovuara në sistem, që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet. • Të ekzistojë lidhje në mënyrë automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që të dhënat në librin kryesor të procesohen në mënyrë automatike . <p>Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operationale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.</p>			<p>Jo nuk është adresuar.</p>
<p>5. Pasiguri ne lidhje me Nenin 16, Shpalosja e pasurive .</p>	<p>Ne këshillojmë që Kryetari të përfshijë burime shtesë në regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e asetëve të komunës dhe të sigurohet se në mënyrë të vazhdueshme Komuna regjistron dhe prezanton në pasqyrat e saj financiare të gjitha pasuritë, si edhe barazon informatat nga të</p>		<p>Pjesërisht është adresuar.</p>	

	gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive.			
6. Pagesat nga palët e treta .	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna po bën përpjekjet maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë tek ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e siguruara duhet të paraqiten drejt në regjistrin e pasurive të komunës. Praktika e mirë do të kërkonte që në baza vjetore të bëhet barazimi i të dhënave mes palëve të treta dhe komunës për investimet në Komunë për vitin përkatës.	Po është adresuar .		
7. Mungesa e kontrolleve dhe vlerësimeve mbi arkëtimin e të hyrave.	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa të mëtjshëm për përmirësimin e kontrolleve dhe se vepron në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve vendore lidhur me arkëtimet e të hyrave.		Pjesërisht e adresuar.	
8. Mungesa e strukturave të auditimit.	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të krijojë një Departament Auditimi të Brendshëm dhe Komitet Auditimi, si dhe të vendosë politika të përshtatshme dhe procedura që sigurojnë standarde të larta të qeverisjes. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësimet për sa i përket: <ul style="list-style-type: none"> • Procesi i raportimit financiar dhe kontabilitetit të komunës; • Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga menaxhmenti; • Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; • Të rishikohet përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në të gjithë komunën në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore. 			Jo nuk është adresuar.